URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 240, datë 7.4.2020

PËR VETËKARANTINIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË, TË CILËT DUAN TË FUTEN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA TË GJITHA PIKAT KUFITARE TOKËSORE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 1, germa "c" dhe 3, germa "a", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJNË:

1. Shtetasit shqiptarë, të cilët paraqiten në pikat e kalimit kufitar tokësor, në shkelje të parimit bazë të mbrojtjes së shëndetit publik nga COVID-19, që nuk janë rezident në vende të tjera, të vetëkarantinohen për një periudhë 14-ditore, nën masa të rrepta sigurie, me shpenzimet e tyre, në struktura akomoduese pranë pikave kufitare, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme.
2. Shtetasit rezidentë në vende të tjera nuk do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Strukturat e Policisë së Shtetit pranë zonave kufitare të sigurojnë ruajtjen në strukturën akomoduese ku do të jenë personat e vetëkarantinuar.
4. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë, të personave që hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
5. Ngarkohen strukturat vendore, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, pranë pikave kufitare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj